



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.12/10..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 12 / 10 / 2021

VENDIM

Nr.35, date 12 /10/2021

PËR

**PROJEKTIN E ZBATIMIT ME OBJEKT "REHABILITIM I MEKANIZMIT TE
KOMANDIMIT TE PORTAVE TE UJELESHUESIT DHE SHKARKUESIT
ANESOR TE DIGES PEZE GJYSLIKONE"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e datës 12.10.2021 mori në shqyrtim Projektin e zbatimit për Rehabilitimin e Mekanizmit të komandimit të portave të Ujeleshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anesor të diges Peze Gjyslikone.

Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur nga Bashkia Tirane si shfrytëzues i kësaj dige, kushtet aktuale të diges, si dhe kërkesave të legjislacionit të mesiperm, KKDM,

VENDOSI:

- 1- Të Miratojë në parim Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Tirane për "Rehabilitimin e Mekanizmit të komandimit të portave të Ujeleshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anesor të diges Peze Gjyslikone" si zgjidhje në kushtet e emergjencës për sigurinë e diges.
- 2- Ti kerkoj Bashkise Tirane si shfrytëzues i digës dhe nënobjekteve të saj:
 - o Te kryeje llogaritjet për qendrueshmerine e diges pas rehabilitimit të saj duke marrë në konsideratë të dhënat e materialit mbushës që do të përdoret në trupin e diges si dhe kërkesat e Vendimit Nr. 15 të KKDM, datë 15.02.2021 për klasifikimin e digave në varesi të pasojave në rast të dëmtimit për shkak të veprimtimit sizmik. Raporti përkatës për qendrueshmerine e diges pas rehabilitimit të saj duhet të dërgohet pranë KKDM përpara fillimit të punimeve;
 - o Te kryeje llogaritjet e vales vërsuese në rast të prurjeve maksimale ose dëmtimit të diges si dhe të përgatitë hartat e përmbytjeve për rastet e mesipërme në zonën poshtë diges. Këto dokumenta duhet të dërgohen pranë KKDM brenda vitit 2021.
 - o Te dërgojë për miratim në KKDM, mbikqyresin e punimeve në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, neni 20;
 - o Te kryeje një studim në lidhje me jetegjatesinë e diges dhe ujembledhësit të saj duke qenë se sipas matjeve të kryera nga firma konsulente e Bashkise, rezultoni se volumi aktual i ujit në ujembledhës është zvogëluar afro 75 % në krahasim me volumin e projektuar për këtë dige. Ky studim duhet të përfshijë edhe konkluzionet për efektivitetin e përdorimit dhe masat për administrimin e këtij ujembledhësi në 10 vitet e ardhshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Te marre masat e duhura sipas legjislacionit ne fuqi per nje monitorim te vazhdueshem te gjendjes dhe sigurise se diges pas rehabilitimit te saj dhe informimin cdo 6 muaj te KKDM per nje periudhe te pakten 3 vjecare;
- Te hartoje planin e gadishmerise ne rastet e emergjencave civile brenda vitit 2021 te kerkuar nga KKDM sipas legjislacionit ne fuqi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

